



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE

607A
Nr. ___ prot.

Roskovec, më 13.09.2021

Lënda: Shpallje publike për shpërblimin nga shpronësimi.

**NË KËNDIN E PUBLIKIMIT TË BASHKISË ROSKOVEC DHE NË FAQEN ZYRTARE TË
BASHKISË ROSKOVEC**

Bashkëpronarë: Z. Ilirjan Kongoli, Znj. Hajrie Shehu, Z. Ymid Resuli, Znj. Mehdije Hoxha, Z. Eqerem Risilia, Z. Kujtim Kryeziu, Z. Xheladin Kryeziu, Znj. Pranvera Kryeziu, Z. Muharrem Resuli, Z. Et'hem Resuli, Znj. Senije Resuli, Z. Mberto Resuli, Znj. Rubie Risilia, Z. Jolldiz Bedini;

Në zbatim të VKM-së 435, datë 15.07.2021 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec";

Duhet të paraqisni dokumentacionin justifikues për kompesimin, për pasurinë e shpronësuar, në Bashkinë Roskovec, në mënyrë që të vijohet procedura përkatëse për kompesim.

Dokumentacioni që duhet të paraqisni për likuidim pranë Bashkisë Roskovec është:

1. Kërkesë për shpërblim nga shpronësimi drejtuar Bashkisë Roskovec,
2. Kartela e rifreskuar e pasurisë e tre muajve të fundit,
3. Prokurë e posaçme përfaqësimi, kur nuk paraqitet personalisht personi i cili ka emrin në listën e pronarëve të shpronësuar me VKM,
4. Vërtetim nga banka për llogarinë bankare, ku të përcaktohet numri i llogarisë dhe numri i IBAN-it. (Këtë vërtetim e merr nga banka personi i interesuar),
5. Fotokopje e kartës së identitetit,
6. Dëshmi trashëgimie, kur personi që shpronësohet nuk jeton.

Nga ana e Bashkisë Roskovec vetëm pas paraqitjes dhe protokollimit të këtij dokumentacioni pranë institucionit, do të vijohet me procedurën e likuidimit të vlerës së shpronësimit.

Kërkohet dorëzimi i dokumenteve të sipërcituara në mënyrë që të vijohet me likuidimin e vlerës së shpronësuar.

